



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 26.05.2023

Nr: 154

Ora: 12:15

VENDIM I NDËRMJETËM

**PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 81, DATË 23.05.2023 DHE NR. 86,
DATË 25.05.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 26.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 dhe nr.86, datë 25.05.2023

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 26.05.2023 Nr: 154
Ora: 12:15



“Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 dhe nr. 86, datë 25.05.2023”

VËREN:

Subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 81 regj., datë 23.05.2023.

Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 86 regj., datë 25.05.2023.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, në datën 26.05.2023, me vendimet nr. 143 dhe nr. 153, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ. Relatori i kërkesave ankimore përkatësisht z. Elvin Lako konstatoi se të dy kërkesat kishin të njëjtin objekt:

- 1. Kërkesë për ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjet e këshillit të bashkisë Kamëz, për QV-të nr. 1575/00 dhe QV nr. 1597/02.*
- 2. Kundërshtim i vendimit nr. 536, datë 20.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.*

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave nr. 81 dhe nr. 86 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 81, është regjistruar më parë në regjistrin e ankimeve se kërkesa ankimore nr. 86, datë 25.05.2023, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Elvin Lako.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 81, datë 23.05.2023 dhe nr. 86, datë 25.05.2023.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 31.05.2023 ora 15:00.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**